REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr.002/02
Datë:02.02.2026

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr. 03/L-040, neni 52, Statutit të Komunës së Junikut (të datës 29.9.2010), neni 36 dhe 37, Kuvendi Komunal në Junik në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 02.02.2026, mori këtë:

VENDIM

Për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

I. Me këtë vendim Kuvendi themelon Komitetin për Politikë dhe Financa si komitet i përhershëm në Komunën e Junikut dhe përcakton strukturën e tij.

II. Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr. 03/L-040, neni 52.1, Komitetit për Politikë dhe Financa Kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit.

III. Komiteti për Politikë dhe Financa do të ketë përbërjen si në vijim:

1. Leonard Llolluni - Kryesues, subjekti politik AAK,
2. Ajshe Gacaferi - anëtare, subjekti politik AAK,
3. Bedrush Hoxha - anëtarë, subjekti politik LDK,
4. Litafete Isufaj - anëtare, subjekti politik LDK,
5. Jetmir Tofaj - anëtarë, subjekti politik LVV.

IV. Komiteti për politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshire edhe dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm, dhe çdo ndryshim të buxhetit për vitin fiskal, si dhe për marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL,
- Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa
- Drejtoria për Ekonomi Buxhet dhe Financa,
- Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard Llolluni